

L I G J
Nr.7810, datë 6.4.1994

PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë arsimi i lartë publik garantohet dhe financohet nga shteti.

Arsimi i lartë publik është laik.

Misioni i arsimit të lartë është:

- a) Të formojë specialistët e lartë.
- b) Të përgatitë shkencëtarët e rinj.
- c) Të krijojë , zhvillojë , mbrojë e transmetojë dijet me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të zhvillojë dhe tejçojë artet e bukura, edukimin fizik dhe sportet.

Neni 2

Arsimimi i lartë kryhet në shkolla të larta universitare dhe shkolla të larta jouniversitare.

Neni 3

Shkollat e larta janë persona juridikë që drejtohen nga rektori ose drejtori.

Neni 4

1. Universitetet janë institucione mësimore -shkencore që kanë për detyrë:

- a) të realizojnë arsimimin profesional dhe formimin shkencor nëpërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor;
- b) të kryejnë studime shkencore në të gjitha fushat që mbulojnë dhe të përgatitin shkencëtarët e rinj.

2. Shkollat e larta jouniversitare janë institucione mësimdhënëse, ku veprimtaria shkencore ka karakter zbatues dhe si detyra kryesore kanë realizimin e arsimit profesional.

Neni 5

Krahas detyrave kryesore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, shkollat e larta mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me aspektet e zbatimit praktik të mësimdhënies e të kërkimit shkencor, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 6

Shkollat e larta kanë liri akademike në mësimdhënie, në kërkimin shkencor dhe në qarkullimin e lirë të ideve. Liria akademike qëndron në respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e

metodave dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor, në përputhje me planet dhe programet përkatëse.

Neni 7

Në kuadrin e autonomisë:

a) Personelit mësimor-shkencor të shkollës së lartë i njihet e drejta të zgjedhë organet që përcaktohen në nenin 16 të këtij ligji.

b) Shkollës së lartë i njihet e drejta e propozimit të drejtuesve: Ministri i Arsimit ose një i deleguar i tij thërret mbledhjen e senatit të shkollës së lartë, e cila përzgjedh kandidaturat për rektorin ose drejtorin, zëvendësrektorin dhe anëtarët përfaqësues në Këshillin Kombëtar të Shkollave të Larta. Rektori ose drejtori i shkollës së lartë emërtohet nga Këshilli i Ministrave mbi bazën e kandidaturave të propozuara nga senati dhe nga ky moment ai është i deleguari i Qeverisë në shkollën e lartë.

Rektori ose drejtori ose një i deleguar i tij thërret mbledhjen e këshillit të fakultetit, e cila përzgjedh kandidaturat për Dekan, si dhe përfaqësuesit e fakultetit në senatin e shkollës së lartë. Dekani i fakultetit emërtohet nga rektori mbi bazën e kandidaturave të propozuara nga këshilli i fakultetit.

Dekani ose një i deleguari i tij thërret mbledhjen e këshillit të departamentit e cila përzgjedh kandidaturat për përgjegjës të departamentit në këshillin e fakultetit. Përgjegjësi i Departamentit emërohet nga dekani i fakultetit mbi bazën e kandidaturave të propozuara nga Këshilli i Departamentit.

c) Shkollat e larta janë të lira të hyjnë në marrëdhënie me shkollat e larta të huaja për shkëmbim përvoja dhe bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor, si dhe për kualifikimin e kuadrit. Shkollat e larta kanë të drejtë të vendosin marrëdhënie dhe të anëtarësohen në shoqata ose organizata ndërkombëtare të arsimit të lartë a të bashkëveprojnë me fondacione vendase ose të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë. Për këto marrëdhënie informohet Ministria e Arsimit.

Neni 8

1. Mjediset ku e ushtron veprimtarinë shkolla e lartë, gëzojnë paprekshmërinë.

2. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose lejen e rektorit ose drejtorit të shkollës së lartë.

3. Cenimi i paprekshmërisë së shkollës së lartë ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në rastet e kryerjes së një krimi flagrant ose kundër jetës dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore organet e rendit publik mund të ndërhyjnë edhe pa lejen e rektorit ose drejtorit të shkollës së lartë.

KREU II

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHKOLLAVE TË LARTA

Neni 9

1. Shkollat e larta përbëhen nga fakultetet; fakultetet përbëhen nga departamentet dhe departamentet përbëhen nga seksionet.

2. Fakulteti është njësi mësimore-shkencore e shkollës së lartë që mbulon shkenca me trung të përbashkët.

3. Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore e shkollës së lartë. Ai përbëhet nga disa seksione. Objekti i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Objekti i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor të seksionit përfshin një disiplinë të një shkence.

Neni 10

Në strukturat e njësive të shkollave të larta përfshihen institutet, qendrat dhe sektorët

kërkimorë, laboratorët dhe atelitet mësimore, klinikat, shërbimet, studiot, bibliotekat, qendrat sportive, muzetë etj., që funksionojnë sipas rregullorëve të brendshme.

Neni 11

1. Hapja dhe mbyllja e fakulteteve dhe e instituteve kërkimore që përfshihen në strukturën e shkollave të larta universitare, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimit të Këshillit Kombëtar të Shkollës së Lartë.

2. Hapja dhe mbyllja e departamentit dhe e njësive ose strukturave mësimore-shkencore më të vogla bëhet me vendim të Ministrisë së Arsimit, mbi bazën e propozimit të senatit të universitetit ose senatit të shkollës së lartë jouniversitare.

Neni 12

Këshilli Kombëtar i Shkollave të Larta është organ këshillimor i Këshillit të Ministrave dhe funksionon në mënyrë kolegjiale. Ai bën propozime për problemet më themelore të arsimit të lartë.

Neni 13

Detyrat dhe kompetencat kryesore të Këshillit Kombëtar të Shkollave të Larta përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

1. Kryetar i Këshillit Kombëtar të Shkollave të Larta është ministri i Arsimit.

2. Këshilli Kombëtar i Shkollave të Larta përbëhet nga anëtarë të brendshëm dhe anëtarë të jashtëm. Numri i anëtarëve është 31, nga të cilët 21 të brendshëm dhe 10 të jashtëm.

a) Anëtarët e brendshëm janë rektorët ose drejtorët e shkollave të larta, si dhe përfaqësues të zgjedhur nga senatet e shkollave të larta. Për çdo shkollë të lartë senati i shkollës zgjedh përfaqësues, në përpjesëtim me numrin e studentëve e të pedagogëve të shkollës, me mandat 3-vjeçar.

b) Anëtarët e jashtëm janë personalitete të rëndësishme kombëtare në fushat e shkencave, ekonomisë, drejtorisë, kulturës dhe artit. Ata emërohen një herë në tre vjet me vendim të Këshillit të Ministrave në bazë të propozimit të Ministrisë së Arsimit.

Neni 15

Këshilli Kombëtar i Shkollave të Larta harton rregulloren e vet, që miratohet me votim të hapur, me jo më pak se 2/3 e votave.

Neni 16

1. Senatet dhe Këshillat e Shkollave të Larta janë organe kolegjiale të zgjedhura që vendosin për problemet më të rëndësishme të shkollës së lartë në fushën e mësimi, të kërkimit shkencor dhe në atë administrativo-financiare.

2. Senati është organ epror i shkollës së lartë dhe ndjek vazhdimisht të gjitha problemet e saj.

Në fakultete zgjidhet këshilli i fakultetit dhe në departamente zgjidhet këshilli i departamentit.

3. Përbërja, detyrat, kompetencat dhe funksionimi i senateve të universiteteve dhe shkollave të tjera të larta dhe i këshillave të njësive të tyre përcaktohen në statutet e shkollave të larta.

Neni 17

1. Autoritetet e shkollave të larta janë:

a) Rektori për shkollën universitare.

b) Drejtori për shkollën jouniversitare.

c) Dekani për fakultetin.

- ç) Përgjegjësi i departamentit për departamentin.
2. Autoritetet e shkollave të larta zgjidhen me votim të fshehtë dhe delegohen sipas nenit 7.
3. Detyrat dhe kompetencat e autoriteteve të shkollave të larta burojnë nga ky igj dhe përcaktohen me hollësi në statutet e shkollave të larta.

Neni 18

- a) Rektori ose drejtori është njëkohësisht kryetar i senatit.
- b) Dekani është kryetar i këshillit të fakultetit.
- c) Përgjegjësi i departamentit është kryetar i këshillit të departamentit.

Neni 19

Përgjegjësi i departamentit , dekani e zëvendësrektori dhe rektori ose drejtori zgjidhen çdo tre vjet. Ata nuk mund të zgjidhen më shumë se dy herë radhazi.

Senati dhe këshillat e njësive të shkollave të larta zgjidhen çdo 3 vjet me shumicë votash.

Neni 20

1. Si rregull, rektorët e zëvendësrektorët dhe dekanët e universiteteve duhet të kenë emërtesën “Profesor”, por në asnjë rast më të ulët se “Asistent profesor”.
- Si rregull, kancelarët e të dy niveleve dhe përgjegjësit e departamenteve duhet të kenë emërtesën “Profesor” ose “Asistent profesor”, por në asnjë rast nuk duhet të jenë pa gradën “Doktor i shkencave”.
2. Anëtarë të senatit dhe anëtarë të brendshëm të këshillit kombëtar të shkollave të larta mund të zgjidhen vetëm punonjësit me gradë shkencore. Anëtarët e jashtëm si rregull duhet të kenë gradë shkencore.

KREU III MARRËDHËNIET FINANCIARE DHE ADMINISTRATIVE

Neni 21

Shkollat e larta janë institucione buxhetore. Ato financohen nga shteti sipas ligjit “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit” dhe sipas akteve nënligjore në zbatim të tij. Buxheti i çdo shkolle të lartë duhet të jetë një zë më vete në buxhetin për arsimin.

Neni 22

Shkollave të larta, në përputhje me aktet nënligjore, u jepen fonde për kërkimin shkencor nga pjesa e buxhetit për shkencën e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, si dhe nga pjesa e buxhetit e ministrive të tjera, për të nxitur e realizuar pjesëmarrjen në programe të përbashkëta të kërkimit dhe zbatimit shkencor.

Neni 23

Krahas pjesës së shpenzimeve të dhëna nga buxheti i shtetit, shkollat e larta kanë të drejtë të krijojnë të ardhura nga veprimtari kryesore e dytësore dhe nga bashkëveprimi me të tretët, vendas a të huaj, në përputhje me mundësitë dhe aktet ligjore e nënligjore që përcaktojnë rregullat e krijimit e të përdorimit të këtyre të ardhurave.

Neni 24

1. Ministria e Arsimit miraton strukturën orientuese të administratës së shkollave të larta, në të gjitha nivelet, mbi bazën e propozimit të Këshillit Kombëtar të Shkollave të Larta.

2. Për mbarëvajtjen administrative dhe ekonomike të shkollës së lartë:
 - a) Rektori emëron, me propozim të senatit, kancelarin e universitetit.
 - b) Dekani emëron, me propozim të këshillit të fakultetit, kancelarin e fakultetit.
 - c) Drejtori emëron, me propozimin e senatit të shkollës së lartë jouniversitare kancelarin e shkollës së lartë jouniversitare.

KREU IV PERSONELI I SHKOLLAVE TË LARTA

Neni 25

1. Personeli i shkollave të larta përbëhet nga:
 - a) punonjësit mësimorë-shkencorë (profesorë, asistentë profesorë, pedagogë, asistentë etj.) të brendshëm dhe të jashtëm;
 - b) personeli ndihmës mësimor-shkencor (preparatorë, laborantë etj.);
 - c) personeli administrativ dhe teknik;
 - ç) personeli bibliotekar;
 - d) personeli ndihmës dhe teknik dhe punëtor.
2. Detyrat dhe të drejtat e personelit të shkollave të larta përcaktohen në statutin e shkollës së lartë dhe në rregulloren e brendshme të njësive përbërëse të shkollës.

Neni 26

1. Komisioni i kualifikimit shkencor, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Shkollave të Larta, miraton klasifikimin për punonjësit mësimorë-shkencorë. Për numrin e vendeve të punës të punonjësve mësimorë-shkencorë, si dhe për klasifikimin dhe numrin e vendeve të punës për personelin administrativ vendos Ministria e Arsimit.
2. Vendet e punës për punonjësit e brendshëm mësimorë-shkencorë, për personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ dhe atë bibliotekar jepen me konkurs dhe aktivizohen mbi bazën e kontratës së punës, në përputhje me ligjin, statutet e universiteteve të shkollave të larta dhe rregulloret e veçanta.

Neni 27

Punonjësit e brendshëm mësimorë-shkencorë janë të detyruar të shërbejnë në shkollën e lartë ku bëjnë pjesë, duke qenë të zënë me punë të paktën deri në kufirin minimal të normës vjetore mësimore-shkencore. Përcaktimi i normave mësimore-shkencore bëhet me vendim të Ministrisë së Arsimit, në bazë të propozimeve të senatave të shkollave të larta.

Për të plotësuar nevojat e realizimit të procesit mësimor-shkencor, shkolla e lartë thërret punonjës të jashtëm me kontrata të afateve të ndryshme, modalitetet e trajtimit të tyre bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Statutet e shkollave të larta paraqiten për miratim në Ministrinë e Arsimit jo më vonë se 3(tre) muaj nga koha që ky ligj hyn në fuqi. Në qoftë se brenda një muaji nga dita e paraqitjes në ministri të statutit, ministria nuk shprehet mbi këtë statut, ai konsiderohet i miratuar.

Statutet e shkollave të larta dhe rregulloret e brendshme të njësive përmirësohen sa herë që shfaqet domosdoshmëria.

Neni 29

Punonjësit mësimorë-shkencorë të shkollave të larta u lejohej që çdo 7 vjet të kualifikohen, specializohen a të punojnë jashtë shtetit në një sektor (institucion) që mbulon fushën e tyre, për një periudhë kohe deri në një vit. Kjo kohë mund të konsumohet si i tërë ose me pjesë.

Nga ky nen përjashtohen rastet e studimeve të plota pasuniversitare jashtë shtetit, të cilat të realizohen në përputhje me planet e kualifikimit të miratuara.

Në të gjitha rastet nënshkruhet një kontratë e posaçme me shkollën e lartë.

KREU V STUDENTËT

Neni 30

1. Për shtetasit e Republikës së Shqipërisë pranimet në shkollën e lartë për çdo sistem të saj, me dhe pa shkëputje nga puna, si rregull bëhen me konkurs. Modalitetet e organizimit të konkurseve të pranimit dhe të vlerësimit të rezultateve përcaktohen në statutet e shkollave të larta.

2. Organizimin e konkurseve e bën shkolla e lartë, e cila në përfundim të konkursit pranon studentët fitues sipas kuotave të miratuara.

3. Kuotat e pranimit në shkollat e larta për sistemin e studimeve me shkëputje nga puna propozohen nga Ministria e Arsimit dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Për sistemin e studimeve pa shkëputje nga puna kuotat përcaktohen nga Ministria e Arsimit, mbi bazën e propozimeve të shkollave të larta. Ministria e Arsimit ushtron kontroll për mbarëvajtjen e konkurseve dhe respektimin e kuotave dhe atë të miratimit të datave të konkurseve.

4. Pranimi i studentëve të huaj në shkollat e larta të Republikës së Shqipërisë bëhet mbi bazën e kriterëve që miraton Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Shkollave të Larta ose mbi bazën e kriterëve të miratuara me marrëveshje qeveritare dypalëshe a shumëpalëshe.

Neni 31

1. Studenti i fiton cilësitë si i tillë me regjistrimin në shkollën e lartë dhe humbet me marrjen e diplomës a të dëshmisë ose me përjashtimin nga shkolla e lartë.

Studentët zbatojnë detyrimet e përcaktuara në statutin e shkollës së lartë, në të cilën bëjnë pjesë.

2. Studentët universitarë dhe pasuniversitarë kanë të drejtë:

a) Të përdorin të gjitha instalimet dhe pajisjet e shkollës për plotësimin e punës së tyre mësimore e shkencore, sipas programeve dhe rregullave përkatëse.

b) Të përfaqësohen në të gjitha këshillat e shkollës, duke përfshirë edhe senatin, në përputhje me modalitetet e përfaqësimit të caktuara në statutin e shkollës së lartë.

c) Të përfitojnë bursë studimi, kur plotësojnë kushtet e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Studentët e shkëlqyer marrin bursë dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga shkolla e lartë. Bursat për studentët e shkëlqyer stimulohen nga shteti me fond të veçantë që u akordohen shkollave të larta, kurse shpërblimet i mbulon vetë shkolla e lartë nga një pjesë e të ardhurave që krijon në përputhje me nenin 23.

Neni 32

1. Studentët kanë të drejtë që në shkollë të organizohen në shoqata studentore jopolitike.

2. Çështjet që kanë të bëjnë me administrimin, organizimin dhe funksionimin e shoqatave studentore, përcaktohen me akte ligjore e nënligjore.

Neni 33

Në shkollat e larta, me propozimin e senatit, Ministria e Arsimit mund të krijojë një sektor informacioni për studimet, mundësitë e punësimit, për orientimin profesional dhe sigurimin e asistencës shoqërore për ata që kanë nevojë etj.

KREU VI STUDIMET UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE

Neni 34

1. Koha e plotë e studimeve në shkollat universitare ndahet në vite akademike dhe nuk është më e vogël se 4 vjet.
2. Për shkollat jouniversitare kjo kohë nuk është më e vogël se 2 vjet.
3. Për çdo fushë koha e studimeve miratohet nga Këshilli i Ministrave, mbi bazën e propozimit të Ministrisë së Arsimit.

Neni 35

Shkollat e larta funksionojnë mbi bazën e planeve mësimore që hartohen në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe miratohen prej senatit të shkollës së lartë.

Neni 36

Programet mësimore hartohen dhe administrohen në mënyrë të pavarur nga çdo lektor ose grup lektorësh, konsultohen në mbledhjen e seksionit ose të departamentit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit, në kuadrin e disa kriterëve të përgjithshme kombëtare të hartuara nga Këshilli Kombëtar i Shkollave të larta.

Neni 37

Pranë shkollës universitare mund të hapen shkollat pasuniversitare. Fondet për organizimin dhe funksionimin e tyre parashikohen në buxhetin e shtetit.

Hapja e shkollës pasuniversitare, për një fushë të dhënë të shkencës, bëhet nga Këshilli i Ministrave në përputhje me aktet nënligjore të posaçme.

Sistemi i bursave dhe tarifave për studimet pasuniversitare përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Shkollat e larta japin grada dhe tituj shkencorë sipas mënyrave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Pranë shkollave të larta, kur plotësohen kushtet, hapen kurset e kualifikimeve afatshkurtër e afatgjatë, si dhe kurset e specializimeve për specialistët me arsim të lartë, sipas mënyrave të përcaktuara në aktet e Këshillit të Ministrave.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40

1. Për mosfunksionimin e rregullt a mosrealizimin e detyrave nga organet ose autoritetet e shkollave të larta, ministri i Arsimit mund të pezullojë ose të shfuqizojë vendimet e tyre, pasi të konsultohen me Këshillin Kombëtar të Shkollave të Larta. Në raste emergjente, kur Këshilli Kombëtar i Shkollave të Larta nuk mund të mbledhet menjëherë, ministri i Arsimit mund të vendosë vetë, por pas kësaj lajmëron brenda 3 ditëve Këshillit Kombëtar të Shkollave të Larta. Në rast mosmarrëveshjeje çështja i kalon Këshillit të Ministrave. Rektori ose drejtori ka të drejtë të marrë masa të njëjta për autoritetet ose këshillat e njësive që ka në përbërje të shkollës.

2. Në raste flagrante, kur me veprime të rënda morale, rektori ose drejtori cenon autoritetin e postit, ministri i Arsimit mund të thërrasë zgjedhjet për rektorin e ri.

Në raste të tilla të njëjta rektori ose drejtori mund të thërrasë zgjedhjet për dekanin e ri, kurse

dekani mund të thërrasë zgjedhjet për përgjegjësin e ri të departamentit.

Neni 41

1. Çdo shkollë e lartë harton projekstatutin e vet në përputhje me këtë ligj dhe me udhëzimet e Këshillit Kombëtar të Shkollave të Larta, i cili kujdeset për harmonizimin e këtyre projektstatuteve mbi një trung të përbashkët, duke pasur parasysh edhe specifikat e çdo shkolle të lartë.

2. Projektstatutet e shkollave të larta miratohen nga ministri i Arsimit.

3. Në përputhje me këtë ligj dhe me statutet e shkollave të larta, njësitë e shkollave të larta (fakultetet dhe departamentet) hartojnë rregulloret e tyre të brendshme, të cilat miratohen:

- a) nga rektori për fakultetin;
- b) nga dekani për departamentin.

Neni 42

Shtetasve të Republikës së Shqipërisë, kur plotësojnë kushtet për të ndjekur studimet e larta, u njihet e drejta të studiojnë e të diplomohen në më shumë se një fushë studimi pranë shkollave të larta. Këto bëhen mbi bazën e rregullave të përcaktuara në statutet e shkollave të larta.

Neni 43

1. Akreditimi akademik dhe vlerësimi i cilësisë së institucioneve të shkollave të larta bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

2. Njohja dhe ekuivalentimi i certifikatave, diplomave dhe gradave të fituara në shkolla të larta të huaja, bëhet me akte të Këshillit të Ministrave në përputhje me aktet dhe konventat e Këshillit të Evropës.

Neni 44

Çdo shkollë e lartë ka emrin e saj zyrtar dhe stemën që miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 45

Kreu V në ligjin nr.4624, datë 24.12.1969 “Për sistemin e ri arsimor , si dhe të gjitha vendimet, statutet, rregulloret dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me arsimin e lartë dhe bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.824, datë 20.4.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë , Sali Berisha.